

URDHËR
Nr. 544, datë 30.8.2021

**PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “FMAA” NË
ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË AUTORËVE NË FUSHËN E
KINEMATOGRAFISË DHE TË VEPRAVE TË TJERA AUDIOVIZUALE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, ‘Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to’”, të ndryshuar, si dhe të legjislacionit në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse”,

URDHËROJ:

1. Ripërtëritjen e licencës së shoqërisë “FMAA” në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale”.
2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti